




PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 06/03/2026
PRIMLJENO: 12/29



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026 (Periudha janar-dhjetor 2026)

Malishevë, mars 2026

Lexim i shkurtesave të përdorura:

MKRS-Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport
DKRS-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
UNDP- United Nations Development Program (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)
ReLoaD3- Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 3
OJQ-Organizata Joqeveritare
OSHC-Organizata të Shoqërisë Civile
SHKA- Shoqëria Kulturo-artistike
SHKL-Shoqata për Kulturë dhe Letërsi
SHFMU-Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët
UÇK- Ushtria Çlirimtare e Kosovës

HYRJE

Plani i Punës për vitin 2026 i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, është hartuar duke marrë për bazë planet e të gjithë sektorëve (Kulturë, Muze, Bibliotekë, Rini, dhe Sport), që janë hartuar nga zyrtarët kompetentë dhe përgjegjës me qëllim për të vendosur një kornizë të qartë të zhvillimit dhe organizimit të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në komunën tonë. Me këtë plan kemi për qëllim jo vetëm planifikimin e aktiviteteve për këtë vit, por, në radhë të parë, forcimin e bashkëpunimit me institucione të ndryshme, si: Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, institucione lokale, organizata joqeveritare vendore e ndërkombëtare, shoqata kulturore, individë që kanë talent në lëmi të ndryshme që janë të ndërlidhur me sektorët e DKRS-së, me Këshilla të shkollave e të gjimnazeve të komunës sonë.

Plani synon të mbështesë krijimtarinë individuale, organizatave, grupeve kulturore, grupeve rinore, promovimin e artit, letërsisë dhe kulturës, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme që angazhojnë dhe fuqizojnë komunitetin artistik. Gjithashtu, me këtë plan të detajuar, synohjmë të rrisim bashkëpunimin dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, historike, përfshirë monumentet, artefaktet dhe vlerat e popullit tonë. NJë ndër qëllimet kryesore për ne është edhe krijimi i databazës me të dhëna për trashëgiminë kulturore.

Për ta bërë më realizueshëm këtë plan, ne do të kujdesemi që:

Sektorit për kulturë të fokusohet në zhvillimin e krijimtarisë dhe promovimin e artit, zhvillimin e aktiviteteve letrare dhe artistike, ndërsa Muzeu “Jahir Mazreku” do shndërrohet në qendër për pasurimin, evidentimin dhe promovimin e eksponateve historike dhe kulturore. Biblioteka “Sokol Kryeziu” luaj rol in e saj si qendër edukative dhe letrare për të gjithë qytetarët që duan librin dhe aktivitetet që lidhen me të, dhe kështu, ky institucion do të zhvillojë aktivitete të ndryshme për promovimin e leximit, edukimit dhe krijimtarisë kulturore e letrare.

Sektori për rini, do të rifuqizohet dhe do të shtyjëj përpara proceset për rininë, duke ndihmuar në themelimin e Këshillit Lokal Rinor, mbështetjen e OJQ-ve rinore dhe të rinjve. Focus tjetër me rëndësi në këtë sektor, do të jetë edhe nxitja e pjesëmarrjes aktive dhe e vullnetarizimit.

Sektori për sport do të do të përkujdeset për shtimin e numrit të aktiviteteve sportive jo vetëm në terrenet sportive në qytetin e Malishevës, por edhe në zona lokale duke bashkëpunuar ngushtë me OJQ dhe klube sportive. Gjithashtu, do të përkujdesët dhe luaj rolin e vetë në promovimin e aktivitetit fizik, gjetjen apo zbulimin e talentëve të rinj dhe angazhimin e tyre në aktivitete sportive në të mirë të sportit në komunën tonë. Sektori për sport, do të përkujdeset poashtu që përmes turneve, garave dhe aktiviteteve sportive gjithëpërfshirëse ta shndërrojë komunën tonë në një qendër sportive shembull për komunat tjera.

Plani është udhërrëfyes i qartë për punën e secilit sektor gjatë vitit 2026, është dokument bazik sektorët dhe DKRS-në. kjo, sepse synojmë arritjen e rezultateve të qëndrueshme për zhvillimin kulturor, rinor dhe sportive në komunën e Malishevës.

Me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve, forcimit të bashkëpunimit dhe fuqizimit të sektorëve, fuqizimit të OJQ-ve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, do të organizojë punën e saj sipas:

QËLLIMET STRATEGJIKE, SYNYMET DHE OBJEKTIVAT PËR SECILIN SEKTOR

Sektori për kulturë

Qëllimi Strategjik: Hartimi i Strategjisë për kulturë, promovimi i kulturës, krijimtariisë letrare, trashëgimisë kulturore; përkujdesja dhe ruajtja e monumenteve që kanë vlera historike; nxitja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në zhvillimin e kulturës.

Synimet:

1. Forcimi i OJQ-ve kulturore, SHKA-ve dhe talentëve e aktivistëve kulturorë të komunës.
2. Mbrojtja dhe promovimi i monumenteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore në përputhje me legjisllacionin në fuqi.
3. Nxitja e krijimtariisë dhe pjesëmarrjes aktive të individëve dhe grupeve kulturore për të organizuar aktivitete personale, grupore, shkëmbim përvojash kulturore brenda dhe jashtë vendit.

Objektivat:

1. Organizimi i orëve letrare dhe promovimeve të veprave të autorëve të ndryshëm nga komuna jonë dhe nga vende të tjera që janë me interes për lexuesit tanë.
2. Mbështetje për grupet letrare dhe shoqatat kulturore për zhvillimin e aktiviteteve kulturore-artistike
3. Vizita të vazhdueshme dhe monitorim i kkujdesshëm i monumenteve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore me qëllim të ruajtjes së tyre

4. Hartimi dhe botimi i materialeve promovuese për trashëgiminë kulturore në bashkëpunim me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturor-Prizren dhe institucione të tjera që merren me trashëgiminë kulturore.

Muzeu “Jahir Mazreku”

Qëllimi Strategjik: Pasurimi i muzeut me artefakte dhe gjëra tjera me vlerë nga trashëgimia kulturore, evidentimi dhe promovimi i eksponateve të ndryshme që janë në muze. Muzeu do të shndërrohet në qendër kulturore promovuese për trashëgiminë e komunës sonë.

Synimet:

1. Shtimi i numrit të artefakteve dhe dokumenteve që kanë vlerë kulturore dhe historike
2. Organizimi i ekspozitave dhe publikimeve të eksponatëve dhe gjërave tjerë që janë në muze
3. Rritja e numrit të aktiviteteve muzeale dhe dhe shtimi i numrit të vizitorëve, qofshin ata qytetarë, artdashës, student apo nxënës shkollash.

Objektivat:

1. Kontakt i rregullt me muze dhe institucione kulturore në nivel lokal dhe qendror
2. Identifikimi i të gjitha vlerave të trashëgimisë në qytetin e Malishevës dhe fshatra të komunës si dhe regjistrimi i tyre në databazë.
3. Organizimi i ekspozitave me karakter kulturor, trashëgimi kulturore dhe muzeal.

Biblioteka “Sokol Kryeziu”

Qëllimi Strategjik: Promovimi i leximit, promovimi i kulturës letrare, ofrimi i lexuesit me librin, përfshirja e lexuesit në aktivitete për librin. Biblioteka do të jetë domosdoshmërisht qendër leximi, qendër edukimi, dhe hapësirë për shvillimin e aktiviteteve kulturore.

Synimet:

1. Rritja e numrit të lexuesve
2. Zhvillimi i aktiviteteve letrare dhe edukative që e shtojnë dashurinë për librin tek nxënësi, lexuesi
3. Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive në aktivitete promovuese letrare që zhvillon biblioteka

Objektivat:

1. Organizimi i promovimeve të librave dhe tryezave me tema educative-letrare dhe kulturore por që kanë në fokus librin
2. Mbatja e ekspozitave, kurseve kompjuterike dhe kurseve për gjuhën angleze.
3. Realizimi i orëve letrare dhe aktiviteteve artistike për fëmijë dhe nxënës të SHFMU dhe SHML

Sektori për rini

Qëllimi Strategjik: Angazhimi i të rinjve në aktiviteteve rinore dhe fuqizimi i tyre nëpërmjet procesit të vendimmarrjes;

Synimet:

1. Zhvillimi i aftësive kapaciteteve rinore nëpërmjet programeve me karakter rinor
2. Organizimi i trajnimeve me karakter të fuqizimit direct jo vetëm të të rinjve por edhe të stafit të OJQ-ve
3. Rritja e numrit të aktivistëve rinor, vullnetarëve rinorë që shërbejnë për rininë dhe qytetarët
4. Nxitja e vullnetarizimit dhe evidentimi e njohja e punës vullnetare në përputhje me legjislationin në fuqi

Objektivat:

1. Licencimi i Qendrës Rinore Publike dhe funksionalizimi ligjor i saj sipas legjislationin në fuqi
2. Bashkëpunimi me DIR, MKRS dhe OSBE për projekte rinore
3. Trajnime dhe aktivitete për fuqizimin e rinisë dhe promovimin e vullnetarizimit.

Sektori për sport

Qëllimi Strategjik: Promovimi i sportit dhe aktivitetit fizik si kulturë sportive; organizimi i turnireve sportive; motivimi i talentëve të rinj në veprimtarinë sportive

Synimet:

1. Shtimi i numrit të të rinjve për pjesëmarrjes në aktivitete sportive duke shfrytëzuar tërë hapësirën sportive që ka në dispozicion komuna e jonë
2. Pjesëmarrje në gara vendore dhe ndërkombëtare e talentëve sportive, ekpive sportive, shkollave të futbollit
3. Promovimi i hapësirave sportive me qëllim të ofrimit dhe përfshirjes të talentëve sportiv në aktivitete sportive
4. Fuqizimi i klubeve sportive nëpërmjet përkrahjes me subvencione nga komuna

Objektivat:

1. Fuqizimi i sektorit të sportit
2. Rritja e angazhimit për shtimin e aktiviteteve sportive
3. Mbështetje të klubeve sportive, individëve, talentëve të rinj, nëpërmjet ofrimit të mundësive për shfrytëzimin e hapësirave sportive që disponon komuna jonë
4. Bashkëpunim me klubet sportive për organizimin e aktiviteteve sportive në komunën e Malishevës

Shënim 1. Aktivitetet që zhvillohen në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” janë pjesë e planit të punës së DKRS-së dhe do të zhvillohen në koordinim ndërmjet zyrtarëve kompetentë.

Shënim 2. Aktivitetet që zhvillohen në Palestren sportive “Habib Zogaj” janë pjesë e planit të punës së DKRS-së dhe do të zhvillohen në koordinim ndërmjet zyrtarëve kompetentë.

Shënim 3. Aktivitetet që realizohen në kuadër të thirrjes publike për mbështetjen e OSHC-ve nëpërmjet programit ReLOaD3 do të zhvillohen në bashkëpunim me OSHC dhe UNDP.

Shënim 4. Aktivitetet që realizohen në kuadër të thirrjes publike për mbështetjen e OJQ-ve do të zhvillohen në bashkëpunim me OJQ-të.

AKTIVITET E PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E KULTURËS

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Qëllimi bazik	Veprimet	Koha e realizimit
	Bashkëpunimi ndër institucional me institucione kulturore, organizata vendore e ndërkombëtare, Institute etj.	Krijimi i mundësive të bashkëpunimit në të mirë të zhvillimit të kulturës	Takime pune me përfaqësues të institucioneve gjatë tërë vitit	Janar-dhjetor
	Flaka e Janarit	Nderimi i të rënëve Ali Kryeziu e Hysni Mazreku dhe të plagosurve në demonstratë; përkujtimi i ngjarjeve të Janarit 1990	Konkursi letrar në poezi; Ora letrare dhe shpallja e fituesve; Homazhe; Botimi i librit me kumtesa dhe materiale të konkursit	Janar
	Dita e Pavarësisë së Kosovës	Nderimi i Ditës së Pavarësisë	Akademia përkujtimore; Nderime të varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz	Shkurt
	Epopeja e UÇK-së	Përkujtim i ngjarjeve të marsit 1998; nderim komandantit Adem Jashari dhe të gjithë të rënëve	Akademia përkujtimore; Nderime të varrezat e dëshmorëve	Mars
	Mbështetje për Grupin letrar të krijuesve të rinj	Zhvillimi i vlerave letrare dhe mbështetja e talentëve të rinj	Formimi i grupit letrar; Mbajtja e orëve letrare; Përrime të veprave të letrarëve të rinj	Mars
	Aktivitete letrare me Karvanin e Shkrimtarëve për Fëmijë "Agim Deva"	Bashkëpunim letrar dhe nxitja e krijimtarisë për fëmijë	Aktivitetet në SHFMU të komunës së Malishevës	Mars-Maj
	Aktivitete letrare në bashkëpunim me SHKL "Tafil Kelmendi"	Organizimi i ngjarjeve kulturore dhe letrare	Përrime librash; Orë letrare; Botime librash	Prill-Dhjetor
	Trashëgimi kulturore e komunës së Malishevës	Promovimi i trashëgimisë kulturore	Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve; Fushata vetëdijesimi për rëndësinë e trashëgimisë	Prill-Tetor

	Aktivitete të përbashkëta me SHKA	Bashkëpunim kulturor dhe artistik me SHKA-të	Mbështetje e aktiviteteve të SHKA-ve	Janar-Dhjetor
	Vizita monumenteve të trashëgimisë kulturore	Përkujdesja për monumentet	Vizita pune në terren; Verifikimi i gjendjes së objekteve dhe monumenteve	Janar-Dhjetor
	Inventarizimi i artefakteve që janë në Muzeun e qytetit "Jahir Mazreku"	Pasurimi i biografisë së artefakteve	-Krijimi i librit protokollar për secilin artefakt që është në Muzeun e qytetit "Jahir Mazreku"	Prill-maj
	Shënimi i Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës	Shënimi i Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës	<ul style="list-style-type: none"> -Shpallja e konkursit artistik për krijime letrare, pikturë dhe këngë -Ora letrare dhe shpallja e rezultateve të konkursit në lëmin e krijimeve letrare (poezi) -Ekspozita artistike dhe shpallja e rezultateve për fituesit e konkursit në pikturë -Akademi përkujtimore -Nderime të varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz -Programi kulturor-artistik -Mbrëmje kulturore (Koncert festiv) 	Qershor
	Festivali Folklorik "Oda e Llapushës"-edicioni i dhjetë	Organizim kulturor në nderim të folklorit vlerave të folklorit	<ul style="list-style-type: none"> -Themelimi i Këshillit Organizativ -Takime me rapsodë dhe grupe rapsodësh -Takime me SHKA dhe grupe të valleve Njoftimet publike për festivalin 	Gusht

				Nata e parë e festivalit Nata e dytë e festivalit-Finalja	
Shënimi i 28 Nëntorit		Shënimi i 28 Nëntorit-Dita e Pavarësisë së Shqipërisë, dalja publike e UÇK-së		Akademia Përkujtimore dhe program i shkurtër artistik	Nëntor
Strategjia për Kulturë		Hartimi i Planit për Kulturë		Formimi i grupit punues; Përgatitja e draftit; Dëgjimi publik; Miratimi në kuvendin e komunës	Prill-Dhjetor
Organizimi i ceremonisë për shpalljen e më të dalluarve në sektorin e kulturës, muzeut, dhe bibliotekës		Nderimi i veprimtarëve, shoqatave kulturore dhe SHKA-ve		Formimi i komisionit vlerësues; Organizimi i ceremonisë	Dhjetor

AKTIVITET E PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E MUZEUT “ JAHIR MAZREKU”

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Qëllimi bazik	Veprimet	Koha e realizimit
	Kontaktet me muze në nivel regional dhe nacional	Funksionalizimi sipas standardeve	Bashkëpunim me MKRS dhe Këshillin për trashëgiminë	Janar-Dhjetor
	Bashkëpunimi me institutin për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore në Prizren	Bashkëpunim dhe këmbim të përvojave në lëmin organizative të muzeve.	Bashkëpunim Takime pune	Janar-dhjetor
	Identifikimi i të gjitha vlerave të trashëgimisë, vizita studimore në fshatra të komunës, botimi i katalogut etj.	Pasurimi me eksponate të Muzeut, Promovimi i vlerave kulturore të komunës së Malishevës, Avancimi i pozitës kulturore, turistike dhe ekonomike të komunës së Malishevës	Aktivite vetedijesuese Aktivite hulumtuese me qëllim pasurimin e muzeut	Janar-dhjetor
	Hartimi i strategjisë për mbledhjen dhe evidentimin e eksponateve	Identifikimi, mbrojtja dhe ruajtja e eksponateve	Krijimi i protokolleve dhe dokumentacionit për çdo artefakt	Janar-Dhjetor
	Pajisja e muzeut me gjësende nga lufta e UÇK-së	Prezantimi i vlerave të luftës së UÇK-së	Mbledhja dhe ekspozimi i objekteve personale të dëshmorëve	Janar-Dhjetor
	Dita Kombëtare e Muzeut	Ekspozitë me eksponate të trashëgimisë kulturore	Organizimi i ekspozitës dhe aktivitetet për vizitorët	Maj

Hartimi dhe publikimi i guides me artefakte të vjetra	Shënjimi i objekteve dhe krijimi i hartës së trashëgimisë	Dokumentimi dhe publikimi i guide-s	Shtator-Nëntor
Organizimi i ekspozitës me artefaktet e gjetura	Promovimi i vlerave të trashëgimisë	Ekspozita 1-ditore	Shtator
Publikimi i fletëpalosjes me fotografi dhe të dhëna	Promovimi i vlerave të trashëgimisë	Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve	Shtator-Tetor, Nëntor

AKTIVITET E PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E BIBLIOTEKËS “SOKOL KRYEZIU”

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Qëllimi bazik	Veprimet	Koha e realizimit
	Promovime të librave	Promovimi i autorëve dhe veprave të tyre	Organizimi i tryezave, debateve dhe ekspozitave me tema edukative	Janar-Dhjetor
	Organizimi i tryezave, debateve të nryshme me tema edukative	Diskutime me lexues, poetë, intelektualë për tema të ndryshme me karakter edukativ	Tryeza diskutimi	Janar-dhjetor
	Kurse kompjuteri	Zhvillimi i aftësive digjitale të qytetarëve	Mbajtja e kurseve për përdorimin e kompjuterëve	Janar-Dhjetor
	Kurse të gjuhës angleze	Përmirësimi i njohurive gjuhësore	Kurse fillestare dhe avancuara	Janar-Dhjetor
	Orë letrare	Përmirësimi i aftësive letrare	Organizimi i orëve letrare dhe diskutimeve mbi librat e lexuar	Janar-Dhjetor
	Ekspozitë artistike	Promovimi i artit vizual dhe kreativitetit	Mbajtja e orëve të pikturës dhe ekspozitimi i veprave	Janar-Dhjetor
	Lektura shkollore në grupe	Përforcimi i leximit dhe analizës së literaturës	Organizimi i grupeve të leximit, diskutimeve dhe prezantimeve nga nxënësit	Janar-Dhjetor

AKTIVITET E PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E RINISË

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Qëllimi	Veprimet	Koha e realizimit
	Takime të rregullta pune me përfaqësuesit e OJQ-ve	Takime me karakter pune për të diskutuar lidhur me mundsitë e realizimit të aktiviteteve dhe për ecurinë e aktiviteteve në zhvillim	Takime informuese dhe takime për mbështetje në organizime	Janar-dhjetor
	Licencimi i Qendrës Rinore Publike	Funksionalizimi ligjor dhe sigurimi i kushteve për aktivitate rinore	Procesi i aplikimit për licencim, plotësimi i dokumentacionit ligjor dhe koordinimi me autoritetet	Janar-Mars
	Bashkëpunimi me DIR dhe OSBE	Mbështetje për projektet rinore, përmirësim i kapaciteteve	Takime dhe trajnime bashkëpunuese; Zhvillimi i projekteve të përbashkëta	Janar-Dhjetor
	Fushata vetëdijësimi për parandalimin e bullizmit	Rritja e vetëdijës dhe edukimi mbi respektin	Fushata informuese, leksione dhe ëorkshop-e në shkolla dhe qendra rinore	Shkurt-Prill
	Debate për luftimin e dukurive negative	Zhvillimi i mendimit kritik dhe përforcimi i vlerave pozitive	Organizimi i debateve dhe aktiviteteve interaktive	Shkurt-Maj
	Kampi Rinor Veror	Zhvillimi i aftësive sociale, bashkëpunimi dhe aktiviteti fizik	Aktivitetet grupore, lojërat edukative dhe sportive, ëorkshop-e kreative	Qersho-shtator
	Festivali tradicional MALFEST	Promovimi i kulturës dhe talenteve rinore	Performanca artistike, ekspozita, konkurse dhe aktivitetet interaktive	Korrik
	Dita e Rinisë	Promovimi i të rinjve dhe angazhimi i komunitetit	ngjarje kulturore dhe sportive	Gusht
	Promovimi dhe mbështetja e talentëve të rinj në bashkëpunim me sektorin e kulturës	Zbulimi dhe zhvillimi i talenteve	Aktivitetet promovuese, ekspozita dhe performanca, bashkëpunim me sektorin e kulturës	Janar-Dhjetor
	Trajnime për fuqizimin e Rinisë	Zhvillimi i aftësive lidërshp dhe njohuri praktike	Organizimi i trajnimeve dhe ëorkshopeve	Janar-Dhjetor

	Promovimi i vullnetarizmit	Nxijja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete vullnetare	Fushata dhe aktivitete vullnetare, trajnime dhe koordinimi me organizata lokale	Janar-Dhjetor
	Shënimi i ditës së vullnetarizmit	Vlerësimi i punës së vullnetarëve dhe motivimi i rinisë	Ngjarje, shpërblime dhe aktivitete promovuese	Dhjetor
	Përzgjedhja e më të dalluarve gjatë vitit 2026 në sektorin e rinisë	Motivimi i të rinjve dhe njohja e kontributeve	Komision vlerësues, shqyrtimi i propozimeve dhe ceremonia e shpalljes	Dhjetor
				Totali

AKTIVITET E PLANIFIKUARA NË SEKTORIN E SPORTIT

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Qëllimi bazik	Veprimet	Koha e realizimit
	Bashkëpunim me OJQ-të sportive	Mbështetje e organizatave sportive, zhvillimi i sportit lokal	Takime dhe koordinim me OJQ-të, ndihmë në organizimin e turneve dhe aktiviteteve	Janar-Dhjetor
	Shënimi i 17 Shkurtit -Turnir futboll, ping-pong	Promovimi i sportit dhe përkujtimi i Pavarësisë	Organizimi i turneut, koordinimi i ekipeve, shpërblimi i pjesëmarrësve	Shkurt
	Shënimi i Epopesë së UÇK-së-Turnir Shënjetari dhe shah	Përkujtimi i komandantit Adem Jashari dhe të rënëve të UÇK-së	Organizimi i turnirit, koordinimi i ekipeve, shpërblimi i pjesëmarrësve	Mars
	Të vrapojmë së bashku Gara në atletikë	Stimulimi i talentëve të rinj dhe promovimi i aktivitetit fizik	Organizimi i garës, koordinimi i pjesëmarrësve, regjistrimi i rezultateve, shpërblimi i fituesve	Prill
	Shënimi i 16 Qershorit-Turnire futboll, ping-pong, volejboll	Përkujtimi i Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve	Organizimi i turneve, koordinimi i ekipeve dhe shpërblimi i pjesëmarrësve	Qershor

Garat memoriale në not "Esmir Shala"	Nderimi i notarit Esmir Shala	Organizimi i garave, koordinimi i pjesëmarrësve dhe shpërblimi i fituesve	Korrik
Panairi i sportit	Promovimi i sportit dhe aktivitetit fizik	Ekspozita dhe aktivitete sportive, demonstrime, konkurrime, prezantimi i sportistëve	Shtator
Turnir për 28 Nëntorin futboll, volejboll, ping-pong	Përkujtimi i Pavarësisë së Shqipërisë	Organizimi i turneve, koordinimi i ekipeve, shpërblimi i pjesëmarrësve	Nëntor
Ceremonia e shpalljes së më të dalluarve në sektorin e sportit	Motivimi i sportistëve dhe promovimi i performancave të larta	Komision vlerësues, shqyrtimi i propozimeve, organizimi i ceremonisë	Dhjetor

PRIORITETET E DREJTORISË PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Pas analizimit ta planifikimeve në sektorët e drejtorisë, analizimit të gjendjes në institucionet që menaxhon DKRS, paraqesim prioritetet bazike:

Nr	Prioriteti	Sektori	Veprimet
	Bashkëpunimi ndër institucional me institucione vendore e ndërkombëtare, organizata kulturore, rinore, sportive	Kulturë Rini Sport	Takime pune me përfaqësues të institucioneve gjatë tërë vitit. Krijimi i mundësive të bashkëpunimit në të mirë të zhvillimit të kulturës, rinisë dhe sportit
	Mbështetja e artistëve, krijuesve letrar, aktivistëve rinorë, vullnetarëve rinorë, sportistëve,	Kulturë	Përfshirja në aktivitete të përbashkëta, mbështetje ideve të tyre
	Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe monumenteve	Kulturë	Përkujdesja për monumentet Bashkëpunimi me institucionet kompetente
	Subvencionimi i OJQ-ve dhe klubeve sportive	Kulturë Rini Sport	Mbështetje OJQ-ve nëpërmjet Thirrjes Publike për Subvencione
	Hartimi i rregulloreve për nevojat të DKRS-së	Kulturë Rini Sport	Formimi i grupeve punuese Hartimi i rregulloreve Miratimi i rregulloreve në Kuvend
	Licencimi i Qendrës Rinore Publike	Rini	Funksionalizimi ligjor dhe sigurimi i kushteve për aktivitete rinore
	Themelimi i Këshillit Rinor Lokal	Rini	Themelimi i Këshillit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
	Renovim, përmirësim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës në objekte sportive	Sport	Përkujdesja për infrastrukturën dhe hapësirat sportive

Përfundim

Plani i punës i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është një dokument bazik për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore, dhe sportive në Komunën e Malishevës. Ky plan, është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me sektorët që e përbëjnë drejtorinë dhe me qëllim që ta thellojë bashkëpunimin institucional, ta mbështesë krijimtarinë artistike, të bëjë promovimin e kulturës, trashëgimisë kulturore, të talentëve kulturorë, rinorë dhe sportivë, të forcojë bashkëpunimin institucional dhe të mbështesë krijimtarinë lokale, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e saj. Aktivitetet e planifikuara në këtë plan përbëjnë shtyllën e organizimit për mbështetjen e duhur për sektorët e drejtorisë, për OJQ-të kulturore, rinore, individët, talentët e rinj dhe të dëshmuar, për klubet sportive, si dhe për fuqizimin e tyre. Si i tillë, ky plan, krijon rrugë të re për mbështetjen e vazhdueshme për kulturë, rininë dhe sportin në komunën tonë.



Malishevë, mars 2026